

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 01.03.2022(dymije e njezet e dy), palet lidhin nje kontrate midis tyre

**DHURUES:**Sara Korreshi, atësia Besnik, amësia Nerlita, shtetase Shqiptare, lindur në Lushnje dhe banuese në Tiranë, me adresë B. Curri; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 22/09/1997, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjofim ID nr. 033326532 dhe nr. personal J75922054A, . *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si “Dhuruesi”)*

**PRANUESI DHURIMIT:**Mirel Mjekra, atësia Kujtim, amësia Vjollcë, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Asim Vokshi; Nd. 16; H. 6; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 31/10/1988, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjofim ID nr. 032920734 dhe nr. personal I81031048M, *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si “Përfituesi i dhurimit”)*

### Baza Ligjore

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma “ç” (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma “ç” (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar
- Neni 62, gërma “ll”, neni 63, pika 1, gërma “ç”, si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”

### EKZISTOJNE KETO KUSHTE PARAPRAKE:

- A. Dhuruesi zoteron 1 kuote 50% te perqindjes se pjesemarrjes (me poshte “Kuota e Dhuruesit”) ne kapitalin e shoqerise “ORHER” Shpk., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar me NUIS M02423011U ne Regjistrin Tregtar prane Qendren Kombetare te Biznesit te Republikes se Shqiperise, me Seli ne Tiranw, zona kadastrale me nr. Rruga Asim Vokshi, Komplkesi USLUGA pallati nr. 53 hyrja 3 apartamenti 4 njwsia administrative nr. 9 (me poshte e quajtur “Shoqeria/ne”).
- B. Dhuruesi do ti kaloje nerpermjet dhurimit Pranuesit te Dhurimit, 100% te kuotes qe zoteron ne Shoqerine ORHER shpk (thene ndryshe 50% te pjesmarrjes ne shoqerine ORHER shpk) .
- C. Pranuesi i Dhurimit pranon dhurimin nga ana e Dhuruesit 100% te Kuotes se Dhuruesit”) te identifikuar ne paragrafin (A) dhe (B) me siper dhe te gjitha te drejtat e detyrimet qe lidhen me to

NE KUADER TE KUSHTEVE PARAPRAKE TE MESIPERME, Pranuesi i Dhurimit dhe Dhuruesi, bien dakort te nenshkruajne kete Kontrate sipas kushteve dhe termave te meposhtme:

Dhuruesi,Pranuesi i Dhurimi *ketu e me poshte ne kete Kontrate, se bashku do te referoben si “Palet/ve”*. Kushtet paraprake jane pjese integrale te kesaj Kontrate dhe percaktojne qellimin e Paleve ne lidhjen e saj.

Duke patur parasysh sa me lart Palet bien dakort per sa vijon:



**NENI 1**  
**DHURIMI DHE TRANSFERIMI I PRONESISE**

1.1 Me nënshkrimin e kesaj Kontrate, Dhuruesi i dhuron Pranuesit te Dhurimit perkatesisht 100 % (njqind perqind) te Kuotes se Dhuruesit dhe çdo te drejte e detyrimi te lidhur me to dhe ose qe rrjedh prej tyre. Ky veprim eshte i lejueshem si nga ligji dhe nga Statusi i shoqwrsw.

(ii) Pranuesi i Dhurimi eshte ortaku tjetwr i shoqwrsw si rrjedhoje nuk ka asnje pengese ligjore per kalimin e kuotes Pranuesit te Dhurimit nga ana e Dhuruesit.

1.2 Me nënshkrimin e kesaj kontrate pronesia mbi 100% te kuotes te Dhuruesit dhe te drejtat qe lidhen me to dhe ose rrjedhin prej tyre, perfshire te drejten e votes dhe te dividetit i kalojne pranuesit te Dhurimit dhe Dhuruesi zhvishet teresisht prej tyre.

1.4 Me depozitim e kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit perfundimisht pas nënshkrimit te kesaj Kontrate Pranuesi i Dhurimit do te kete ne pronesi 100 % te kuotes se Dhurimit (thene ndryshe 100% te pjesmarrjes ne shoqerine ORHER shpk).

**NENI 2**  
**DEKLARIME DHE GARANCI**

2.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem per Dhuruesin. Kuota e Dhurimit objekt i kesaj Kontrate i dhurohen Pranuesit te Dhurimit ne gjendjen ne te cilen eshte dhe me te drejtat qe lidhen me te dhe/ose rrjedhin prej saj.

2.2.1 Pranuesi i Dhurimit e pranon Dhurimin objekt te kesaj Kontrate ne gjendjen ne te cilen eshte dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me te apo te drejta qe lidhen me te dhe/ose rrjedhin prej saj.

**NENI 3**  
**TE NDRYSHME**

3.1 Kjo Kontrate pergatitet dhe nënshkruhet ne 4 kater ekzemplar me vlere te njejte secili dhe ky akt perben te gjithë marreveshjen e arritur midis Paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate.

3.2 Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nënshkruhet personalisht nga Palet e kesaj Kontrate apo perfaqesues te autorizuar rregullisht prej seciles nga Palet ne fjale.

**NENI 4**  
**LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

4.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.



4.2 Çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis Paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete Paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

4.3 Une Noteri, e lexoj tekstin e ketij akti me ze te larte dhe te kuptueshem Paleve te cilet, pasi me deklaruan se teksti i ketij akti eshte ne perputhje te plote me theniet dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time ne 6 (gjashte) ekzeplar me vlere te njejte secili, dhe une Noteri vertetoj sa me siper sipas ligjit ne fuqi.

**DHURUESI**

Sera korreshi  
*[Signature]*

**PRANUESI I DHURIMIT**

Mirel Mjekra

